



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 239/8 prot.

Datë 16/02/2024

V E N D I M
Nr. 189/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16/02/2024 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KOMBEAS” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur Punë*” me nr. REF-91817-12-21-2023, me objekt: “*Rikonstruksion shkolla 9 - vjeçare ‘Demokracia’*”, me fond limit 47.500.000 (dyzet e shtatë milion e pesëqind mijë) lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 09.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “KOMBEAS” SHPK me NIPT K88103301J dhe adresë “Fshati Prozhme”, Rruga “Dod Lleshi”, në pasurinë me nr. 6/50, Zona Kadastrale 3441, Kurbin.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës me adresë Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e*

Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.06.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur Punë” me nr. REF-91817-12-21-2023, me objekt: “Rikonstruktion shkolla 9 - vjeçare ‘Demokracia’”, me fond limit 47.500.000 (dyzet e shtatë milion e pesëqind mijë) lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 09.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 09.01.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 18.01.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. NIKA	34,327,640.00	skualifikuar
2. ASI-2A CO	34,954,350.00	kualifikuar
3. NDERTIMI SHPK	36,443,433.00	kualifikuar
4. MF INVEST GROUP	36,535,525.00	skualifikuar
5. NGRACAN 1934	37,083,315.00	skualifikuar
6. INA	37,488,230.00	kualifikuar
7. ERIL CO	37,857,530.00	skualifikuar
8. LIS KONSTRUKSION	38,186,224.76	skualifikuar
9. KEVIN KONSTRUKSION	38,314,940.10	kualifikuar
10. ERGI	38,607,268.00	skualifikuar
11. L.T.E CONSTRUCTION	39,006,861.40	kualifikuar
12. SENKA	39,424,485.00	kualifikuar
13. PEPA GROUP GROUP	39,659,263.30	kualifikuar
14. MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE	39,809,810.00	kualifikuar
15. LIQENI VII	39,819,283.00	kualifikuar
16. T & XH	39,898,761.00	kualifikuar
17. STERKAJ	43,001,625.00	kualifikuar
18. AGB 3	47,182,100.00	skualifikuar
19. LEON KONSTRUKSION	45,598,443.00	kualifikuar
20. C O L O M B O	35,209,965.00	skualifikuar
21. KOMBEAS	31,938,683.00	skualifikuar

II.4. Në datën 26.01.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 04, datë 29.01.2024.

II.5. Në datën 01.02.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3783 dhe me nr. 239/2024 prot., datë 01.02.2024, e operatorit ekonomik “KOMBEAS” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KOMBEAS” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Pretendimet janë si më poshtë vijon:

“Në shkresë argumentojmë se shoqëria jonë ka në stafin e saj personel inxhiniero-teknik të specializuar dhe me eksperiencë në fushën e ndërtimit, ka në pronësi mjete dhe makineri, dhe ka material gjendje në magazinë si rërë, çimento, hekur, kartonxhes, katrama, polisterol që do të përdoren për realizimin e punimeve në objektin “Rikonstruksion i Shkollës 9 - vjeçare Demokracia”. Oferta ekonomike ka dalë nga çmime të bazuara në analiza teknike për çdo zë

punimi të cilat janë kryer përpara dërgimit në sistem. Mbështetur në potencialin ekonomik si dhe pasi kemi bërë kontratat me subjektet private për materialet e ndërtimit sipas preventivit dhe specifikimeve teknike, kemi bërë analizat teknike financiare para ditës së tenderimit të të gjitha zërave të preventivit të objektit. Analizat teknike nuk janë theksuar edhe në shkresën e komisionit vlerësimit të ofertave dt. 15.01.2024 ndaj dhe nuk janë hedhur në sistem sepse në momentin që ne ofertojmë bazohemi gjithmonë në analiza teknike të zërave të punimeve. Po ju bashkëngjisim analizat tekniket dhe kontratat përkatëse nga subjektet private me të cilat ne bashkëpunojmë ndër vite. Kontrata me furnitorët vendas si më poshtë:

? NDUE GEGA ShPK nipt K68201301A për të gjitha produktet baze të ndërtimit

? ZENEPE KAMERI ShPK nipt M18308503R për furnizimin me dyer/dritare

? ALFA-BETON ShPK nipt L68305301B për të gjitha punimet e sistemit terrenit dhe betonit

? BEST-TECH AL 2000 ShPK nipt L81625005U për të gjitha punimet e pajisjeve të sistemit të ngrohjes dhe mbrojtjes nga zjarri

? BRUNES ShPK nipt K37125203H për të gjitha punimet e pllakave dhe pajisjeve hidrosanitare.

Duke patur parasysh se Shoqëria Kombeas sha është e kompletuar me mjete dhe makineri, stafin teknik dhe ka material gjendje në magazinë që do nevojitet për objektin “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Demokracia” si edhe kontrata me furnitorët të cilët na ofrojnë çmime të favorshme për bazën materiale ndërtimore, shoqëria Kombeas sha ka ofertuar me çmime të ulëta duke ju garantuar edhe cilësinë e punimeve. Shoqëria Kombeas sha disponon potencial ekonomik dhe financiar për realizimin e punimeve sipas ofertës ekonomike. Në rast se Shoqëria Kombeas sha shpallet fitues në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Demokracia” ju garantojmë se punimet do të kryhen me cilësi dhe afatin e caktuar. Bashkëngjitur kësaj ankese do të gjeni kontratat me subjektet për furnizimin me materiale sipas proceseve të punimeve për realizimin e objektit bazuar edhe në specifikimeve teknike të projektit të publikuara nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, Shkresën dërguar komisionit të vlerësimit të ofertave për argumentim. Në bazë të ofertës ekonomike të paraqitur nga shoqëria Kombeas sha do të gjeni analizat teknike zë për zë të preventivit të bëra para ditës së tenderimit (22 fletë). Prandaj i kërkoj Komisionit të Ankesave të më marri në konsideratë këtë lapsus të krijuar nga ana e Shoqërisë Kombeas sha duke na kualifikuar.

Referuar vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për interpretim literal të nenit 93, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Sqarojme se:

Shoqëria jonë për sa më sipër, ka provuar të gjitha kushtet për t’i dhënë garanci dhe bindje autoritetit kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës.

Megjithatë ne si shoqëri për sa i përket besueshmërisë, bindjes, garantimit të një kontrate të suksesshme e provojmë edhe me realizim imin po pranë institucionit tuaj si më poshtë:

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar Punë

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-64183-03-29-2023

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Rikonstruksion në Rrugë në Nja Rrashbull”

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Kodi CPV: 45233120-6- Punime ndërtimi për rrugë

Fondi limit: 8'280'660 (Tetë milion e dyqind tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 18 (ditë) Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 11.04.2023 Ora 10.00 .

Ku shoqëria jonë për procedurën e mësipërme REF-64183-03-29-2023 është shpallur fituese pas daljes si ofertë anomalisht e ulët.

Si përfundim kërkojmë pranimin e argumentimit tonë për ofertë anomalisht të ulët dhe kualifikimin e ofertës sonë si oferta më e leverdishme sipas kriterit të përcaktuar në DST”.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 239/2 prot., 01.02.2024 me arsytet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes “KOMBEAS” SHPK.

II.7. Me anë të adresës së e-mailit, operatori ekonomik ankimes “KOMBEAS” SHPK, ka dërguar në adresën zyrtare të e-mailit të Komisionit të Prokurimit Publik, mandat - pagesën, protokolluar me nr. 239/3 prot., datë 01.02.2024.

II.8. Me anë të vendimit Nr. 1649/2 prot., datë 04.08.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr. 239/4 prot., datë 07.02.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar në adresën zyrtare të e-mailit të Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi vendimmarrjen në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.9. Me anë të shkresës Nr. 1649/4 prot., datë 08.02.2024, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr. 239/5 prot., datë 09.02.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur **mospranimi i ankesës**.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “KOMBEAS” SHPK, për skualifikimin e tij me pretendimin se:

“Në shkresë argumentojmë se shoqëria jonë ka në stafin e saj personel inxhiniero-teknik të specializuar dhe me eksperiencë në fushën e ndërtimit, ka në pronësi mjete dhe makineri, dhe ka material gjendje në magazinë si rërë, çimento, hekur, kartonxhes, katrama, polisterol që do të përdoren për realizimin e punimeve në objektin “Rikonstruksion i Shkollës 9 vjeçare Demokracia”. Oferta ekonomike ka dalë nga çmime të bazuara në analiza teknike për çdo zë punimi të cilat janë kryer përpara dërgimit në sistem. Mbështetur në potencialin ekonomik si dhe pasi kemi bërë kontratat me subjektet private për materialet e ndërtimit sipas preventivit dhe specifikimeve teknike, kemi bërë analizat teknike financiare para ditës së tenderimit të të gjitha zërave të preventivit të objektit. Analizat teknike nuk janë theksuar edhe në shkresën e komisionit vlerësimit të ofertave dt. 15.01.2024 ndaj dhe nuk janë hedhur në sistem sepse në momentin që ne ofertojmë bazohemi gjithmonë në analiza teknike të zërave të punimeve. Po ju bashkëngjisim analizat tekniket dhe kontratat përkatëse nga subjektet private me të cilat ne bashkëpunojmë ndër vite. Kontrata me furnitorët vendas si më poshtë:

? NDUE GEGA ShPK nipt K68201301A për të gjitha produktet baze të ndërtimit

? ZENEPE KAMERI ShPK nipt M18308503R për furnizimin me dyer/dritare

? ALFA-BETON ShPK nipt L68305301B për të gjitha punimet e sistemit terrenit dhe betonit

? BEST-TECH AL 2000 ShPK nipt L81625005U për të gjitha punimet e pajisjeve të sistemit të ngrohjes dhe mbrojtjes nga zjarri

? BRUNES ShPK nipt K37125203H për të gjitha punimet e pllakave dhe pajisjeve hidrosanitare.

Duke pasur parasysh se Shoqëria Kombeas sha është e kompletuar me mjete dhe makineri, stafin teknik dhe ka material gjendje në magazinë që do nevojitet për objektin “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Demokracia” si edhe kontrata me furnitorët të cilët na ofrojnë çmime të favorshme për bazën materiale ndërtimore, shoqëria Kombeas sha ka ofertuar me çmime të ulëta duke ju garantuar edhe cilësinë e punimeve. Shoqëria Kombeas sha disponon potencial ekonomik dhe financiar për realizimin e punimeve sipas ofertës ekonomike. Në rast se Shoqëria Kombeas sha shpallet fitues në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Demokracia” ju garantojmë se punimet do të kryhen me cilësi dhe afatin e caktuar. Bashkëngjitur kësaj ankese do të gjeni kontratat me subjektet për furnizimin me materiale sipas proceseve të punimeve për realizimin e objektit bazuar edhe në specifikimeve teknike të projektit të publikuara nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, Shkresën dërguar komisionit të vlerësimit të ofertave për argumentim. Në bazë të ofertës ekonomike të paraqitur nga shoqëria Kombeas sha do të gjeni analizat teknike zë për zë të preventivit të bëra para ditës së tenderimit (22 fletë). Prandaj i kërkoj Komisionit të Ankesave të më marri në konsideratë këtë lapsus të krijuar nga ana e Shoqërisë Kombeas sha duke na kualifikuar.

Referuar vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për interpretim literal të nenit 93, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Sqarojme se:

Shoqëria jonë për sa më sipër ka provuar të gjitha kushtet për ti dhënë garanci dhe bindje autoritetit kontraktor për përmbushjen me sukses kontratën.

Megjithatë ne si shoqëri për sa i përket besueshmërisë, bindjes, garantimit të një kontrate të suksesshme e provojmë edhe me realizimin po pranë institucionit tuaj si më poshtë:

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar Punë

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-64183-03-29-2023

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Rikonstruksion në Rrugë në Nja Rrashbull”

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Kodi CPV: 45233120-6- Punime ndërtimi për rrugë

Fondi limit: 8’280’660 (Tetë milion e dyqind tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 18 (ditë) Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 11.04.2023 Ora 10.00 .

Ku shoqëria jonë për procedurën e mësipërme REF-64183-03-29-2023 është shpallur fituese pas daljes si ofertë anomalisht e ulët.

Si përfundim kërkojmë pranimin e argumentimit tonë për ofertë anomalisht të ulët dhe kualifikimin e ofertës sonë si oferta më e leverdishme sipas kriterit të përcaktuar në DST ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë KPP-së me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 239/3 prot., datë 09.02.2024, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e operatorit ekonomik “KOMBEAS” SHPK është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte KVO më datë 15.01.2024, nëpërmjet SPE i është drejtuar operatorit ekonomik “KOMBEAS” SHPK, me kërkesë që të paraqesë sqarime për ofertën ekonomike dhe elementet e veçanta të saj, brenda tri ditëve pune, me përmbajtje si më poshtë:

“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

Drejtuar ofertuesit: KOMBEAS me NIPT K88103301J

Shpjegim për ofertë anomalisht të ulët për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Demokracia”

- Për sa më sipër, në përputhje me nenin 93 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe DT, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi t’i kërkojë shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë, ofertuesit KOMBEAS me NIPT K88103301J, me vlerë të ofertës 31’938’683 lekë.

Ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së, brenda tri ditëve pune, shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

III.1.2. Referuar dokumentacionit të administruar nga autoriteti kontraktor, por edhe verifikimeve të kryera në SPE rezulton, se në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor, operatori ekonomik “KOMBEAS” SHPK më datë 16.01.2024, ka paraqitur argumentimin me qëllim justifikimin e ofertës anomalisht të ulët si më poshtë:

KOMBEAS SHA
MILOT-KURBIN
NIPT K88103301J
Email : mhill.ndreca@yahoo.com

NR 14 PROT**Dt. 16/01/2024****DREJTUAR : Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës Komisionit Vleresimit Ofertave****LENDË : Shpjegim Për Ofertë Anomalisht Të Ulët Për Proçedurën E Prokurimit Me Objekt: "Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Demokracia"**

Referuar ofertës tonë me vlerë 31'938'683 lekë pa tvsh date 09.01.2024 sipas procedurës prokurimit me objekt "Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Demokracia" ju shpjegojmë si më poshtë:

Shoqëria Kombeas Sha është themeluar me datën 23/05/2008 me numër Nipti K88103301J. Shoqëria Kombeas sha ka në pronësi mjete dhe makineri si dhe personel inxhinierio-teknik për zbatimin e objektit "Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Demokracia".

Shoqëria ka në stafin e saj personel inxhinierio-teknik të specializuar dhe me eksperiencë në fushën e ndërtimit përkatesisht: Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Mekanik, Inxhinier Elektrik, Inxhinier Topograf i gjithë ky personel është në licencën e shoqërisë Kombeas Sha. I gjithë personeli është i kualifikuar.

Shoqëria Kombeas sha ka gjendje material të magazinuar si naftë, stabilizant, rërë, çimento, hekur, kartonxhes, pllaka, polisterol, dhe katrama që do përdoren për realizimin e punimeve në objektin "Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Demokracia". Shoqëria ka në pronësi një inertesh me fraksione të ndryshme në Balldre – Lezhe.

Shoqëria Kombeas sha ka kontratë afatgjatë me furnitoret:

- NDUE GEGA shpk nipt K68201301A për të gjitha produktet baze të ndërtimit
- ZENEPE KAMERI shpk nipt M18308503R për furnizimin me dyer/dritare
- ALFA-BETON shpk nipt L68305301B për të gjitha punimet e sistemit të terrenit.
- BEST-TECH AL 2000 shpk nipt L81625005U për të gjitha punimet e paisjeve të sistemit të ngrohjes dhe mbrojtjes nga zjarri



- BRUNES shpk nipt K37125203H për të gjitha punimet e pllakave dhe paisjeve hidrosanitare

Duke patur parasysh se Shoqëria Kombeas sha është e kompletuar me mjete dhe makineri, stafin teknik dhe ka material gjendje në magazine që do nevojitet për objektin "Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Demokracia" si edhe kontrata me furnitorët të cilët na ofrojnë çmime të favorshme për bazen materiale ndërtimore, shoqëria Kombeas sha ka ofertuar me çmime të ulëta duke ju garantuar edhe cilësinë e punimeve.

Shoqëria Kombeas sha disponon potencial ekonomik dhe financiar për realizimin e punimeve sipas ofertës ekonomike.

Në rast se Shoqëria Kombeas sha shpallet fitues në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Demokracia" ju garantojmë se punimet do të kryhen me cilësi dhe afat në të caktuar.

KOMBEAS SHA
DREJTUES LIGJOR
ING. MHILL NDRECA



III.1.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" përcaktohet se: "1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me

ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”.

III.1.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “KOMBEAS” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 31,938,683.00 lekë pa TVSH (pas korrigjimit të gabimeve aritmetike), në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre, që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis. Në interpretim literal të nenit 93, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit

ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t'i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu, është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi, apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson, se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.6 Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “KOMBEAS” SHPK, në mbështetje të justifikimit dhe argumentimit të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se

operatori ekonomik "KOMBEAS" SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës së ngarkuar në SPE me nr. 14 prot., datë 16.01.2024, por nuk ka paraqitur analizë kostoje të detajuar që të argumentojë kushtet apo elementet, pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se operatori ekonomik "KOMBEAS" SHPK, ka paraqitur argumentimin e tij në formën e një sqarimi narrativ. Në këtë kuptim KPP gjykon, se shpjegimi narrativ përmes shkresës me nr. 14 prot., datë 16.01.2024, e pashoqëruar me dokumente mbështetëse provuese, nuk është e mjaftueshme për autoritetin kontraktor për të krijuar bindjen, se ankimuesi do të sigurojë realizimin me sukses të kontratës. Operatori ekonomik ka dështuar të provojë me dokumentacion mbështetës argumentimin e ofertës anomalisht të ulët dhe pse kjo ofertë e dalë anomalisht krijon bindjen për përmbushjen me sukses të kontratës. Ankimuesi ka detyrimin ligjor, që të prezantojë me dokumentacion provues katër kushtet kumulative të përcaktuara në nenin 93 pika 2 të lex specialis, si dhe mundësinë (në rastet kur ai mund të marrë ndihmë shtetërore) për plotësimin e kushtit të pestë, që do të garantonin realizimin e shërbimit pranë autoritetit kontraktor. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës së përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, nuk është paraqitur dokumentacion provues që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: dorëzimit në mënyrë të detajuar të anës ekonomike të metodës së analizës së kostos së zërave të punimeve të ndërtimit, procesit të prodhimit ose të mallrave të ofruara, metodës së përzgjedhur apo zgjidhjeve teknike të posaçme), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik ankimues "KOMBEAS" SHPK, nuk është paraqitur argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 pika 2 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori duhet të skualifikohet nga ana e autoritetit kontraktor. Edhe pse analizat teknike dhe kontratat me furnitorët janë bashkëlidhur në formularin e ankesës, këto dokumente provuese nuk i janë vënë në dispozicion Komisionit të Vlerësimit të Ofertës, në kohën kur është kërkuar nga kjo e fundit, pasi barra e provës mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik ankimues.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "KOMBEAS" SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik,
Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “KOMBEAS” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur Punë*” me nr. REF-91817-12-21-2023, me objekt: “*Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare ‘Demokracia’*”, me fond limit 47.500.000 (dyzet e shtatë milion e pesëqind mijë) lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 09.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KOMBEAS” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

